



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:227593

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05646962

KPPP.nr. 1701/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kulinare Sh.P.K., me numër unik identifikues 810115718 dhe me seli në Prishtinë, Magjistralia Prishtinë - Ferizaj, km. 10, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokatët Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi nga Prishtina, kundër debitorit M.B. B.I., me numër unik identifikues 811499723 dhe me seli në Prishtinë, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, 49/A-1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 555/2023 i datës 04.10.2023, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Rezarta Metaj nga Prishtina, jashtë seancës me datën 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit M.B. B.I., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 555/2023 i datës 04.10.2023, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Rezarta Metaj, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori M.B. B.I., që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 208.00 (dyqind e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kulinare Sh.P.K., me datë 04.09.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 555/2023, duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 10364/22, e datës 05.11.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të

borxhit sipas faturës së lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën prej 17,036.42 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, prej rënies në vonesë e deri në pagesën definitive të borxhit kryesor, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Ndërsa, duke vepruar sipas plotësimit dhe precizimit të propozimit për përmbartim, me datë 04.10.2023 ka lëshuar urdhrin plotësues P.nr. 555/2023, duke lejuar përmbartimin përveç në bazë të Faturës nr. 10364/22, e datës 05.11.2022, edhe në bazë të Faturës nr. 10618/22, e datës 22.11.2022; Faturës nr. 10721/22, e datës 16.11.2022; Faturës nr. 10786/22, e datës 17.11.2022; Faturës nr. 10994/22, e datës 24.11.2022; Faturës nr. 11171/22, e datës 01.12.2022; Faturës nr. 11266/22, e datës 03.12.2022; Faturës nr. 11268/22, e datës 03.12.2022; Faturës nr. 11269/22, e datës 03.12.2022; Faturës nr. 11277/22, e datës 05.12.2022; Faturës nr. 11472/22, e datës 09.12.2022; Faturës nr. 12051/22, e datës 24.12.2022; Faturës nr. 12067/22, e datës 26.12.2022; Faturës nr. 1153/23, e datës 13.02.2023 dhe Faturës nr. 3124/23, e datës 11.04.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 17,036.42 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe në emër të përpilimit të plotësimit të propozimit për përmbartim në vlerë prej EUR 208.00, sipas tarifës së OAK-së.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor me arsyetim se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të faturave të cilat nuk pasqyrojnë gjendjen reale të mallit të pranuar si për nga lloji edhe nga sasia. Ka shtuar se kontestimi i faturave ka të bëjë edhe me nënshkrimin e tyre, sepse nënshkrimi nuk është i debitorit si dhe nuk janë të vulosura e si të tilla janë të pa pranueshme. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se i njëjti nuk është mbështetur në prova, siç përcaktohet me nenin 69, par. 4 të LPP-së. Tutje, ka shtuar se kreditori e ka furnizuar në vazhdimësi debitorin me mall, e së bashku me shërbimin e ofruar ka pranuar edhe faturat, e për të cilat nuk ka paraqitur vërejtje, si dhe ka paguar një pjesë të tyre përmes transferit bankar. Duke qenë se qëllimi i debitorit është shmangia nga pagesa dhe zvarritja e procedurës, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet debitori që të kompensojë shpenzimet e procedurës në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në vlerë prej 208.00 €, sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 10364/22, e datës 05.11.2022; Fatura nr. 10618/22, e datës 22.11.2022; Fatura nr. 10721/22, e datës 16.11.2022; Fatura nr. 10786/22, e datës 17.11.2022; Fatura nr. 10994/22, e datës 24.11.2022; Fatura nr. 11171/22, e datës 01.12.2022; Fatura nr. 11266/22, e datës 03.12.2022; Fatura nr. 11268/22, e datës 03.12.2022; Fatura nr. 11269/22, e datës 03.12.2022; Fatura nr. 11277/22, e datës 05.12.2022; Fatura nr. 11472/22, e datës 09.12.2022; Fatura nr. 12051/22, e datës 24.12.2022; Fatura nr. 12067/22, e datës 26.12.2022; Fatura nr. 1153/23, e datës 13.02.2023 dhe Fatura nr. 3124/23, e datës 11.04.2023, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbartim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbartimit pasi që janë të përshtatshme për përmbartim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nuk janë pranuar nga debitori apo nga personi i autorizuar i debitorit, mirëpo këto

pretendime i vlerësoj si të pabazuara pasi që debitori nuk ka ofruar asnjë provë siç kërkohet me nenin 69.4 të LPP-së, për të vërtetuar faktin se është iniciuar ndonjë procedurë e veçantë gjyqësore në raport me dyshimet për nënshkrime të paautorizuara, andaj deklarimet e tilla nuk paraqesin shkak për anulimin e urdhrin për lejimin e përmbarimit nga neni 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore gjykata vendosi në kuptim nenit 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet kreditorit në emër përgjigjes në prapësim të ushtruar, në vlerë prej EUR 208.00, konform tarifës së OAK, nr. tarifor 6, lidhur me parashtrirat për përmbarimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 € e më lartë.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1701/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.